



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

Nr. 667/1, datë 26.5.2023

“Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr.667 datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Lazër Sallaku”

Sot në datë 10.07.2023, ora 10:00, trupi gjykues, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.”,*

u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes znj. Brunilda Bekteshi, për korrigjimin e gabimit material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku, për të cilin mbajti procesverbalin përkatës. Në procesverbal relatohet mbi arsyet e pranimit të korrigjimit të vendimit, pas të cilit arrihet në konkluzion se, në vendimin nr.667 datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pjesën hyrëse të tij, në pikën 13 titulluar A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, 2 paragrafët e parë:

- *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; zëvendësohen me paragrafët :*
- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*

Trupa gjykuese pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, në paragrafin/fjalitë e para të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit z.Lazër Sallaku;

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.667 datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pjesën hyrëse të tij, në pikën 13 titulluar A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, 2 paragrafët e parë:
 - *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
 - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; zëvendësohen me paragrafët :*
 - *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjyqësor

Pamela Qirko	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka